



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.1/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e Gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN ndaj Gjyqtares T.K., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt. 15.02.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN kundër gjyqtares T.K., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren me dt. 13.01.2023 nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN ka pranuar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares T.K., Gjyqtare në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prizren. Në kërkesë është cekur se në bazë të ligjit mbi përgjegjësinë disiplinore për Gjyqtar dhe prokuror kanë vlerësuar se gjyqtarja e lartcekur ka kryer Shkelje të rënda të detyrave të punës si gjyqtare giatë trajtimit të tre çështjeve gjyqësore kundër të pandehurit D.H., Gjyqtarja T.K., ka gjykuar çështjet penale P.nr. 1949/2012, P.nr.485/2016 dhe P.nr. 1326/2019. Në të tre rastet subjekt i procedurës penale ka qenë i pandehuri D.H.,. Të tre rastet janë gjykuar dhe kanë marrë formën e prerë. Pas analizës së këtyre rasteve BIRN konsideron se gjyqtarja T.K., ka shkelur dy pika të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror, përkatësisht nenin 5 pika 1.2 dhe nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.15 të cilat parashohin shkeljet disiplinore si shkelje të ligjit dhe përfshirja në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Kërkesën e BIRN -it ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim:

Me datë 14.01.2023, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nga arkiva e gjykatës ka siguruar shkresa të lëndës penale P.nr. 1949/2012, P.nr.485/2016 dhe P.nr. 1326/2019.

Me datë 16.01.2023 Autoriteti kompetent i kësaj gjykate ka iniciuar hetimet preliminare disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtares T.K., dhe në të njëjtën ditë është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për fillimin e hetimeve preliminare disiplinore në këtë çështje.

Ndërsa me datë 19.01.2023 nga gjyqtarja T.K., është kërkuar që të deklarohet për të tre rastet të cilat i ka gjykuar P.nr. 1949/2012, P.nr.485/2016 dhe P.nr. 1326/2019.

Gjyqtarja T.K., me datë 24.01.2023 ka dhënë deklaratë për rastin.

Pas verifikimit dhe analizës së pretendimeve ankimore, është konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prizren pas deklarimit të Gjyqtares dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës vlerëson se sa i përket lëndëve penale P.nr. 1949/2012 dhe P.nr.485/16 nuk mund të iniciohen hetimet për procedurë disiplinore pasi që ka ardhur deri te parashkrimi absolut për fillimin e hetimeve për shkeljet e pretenduara disiplinore. Nga koha kur pretendohet nxjerrja e Aktgjykimeve P.nr.1949/12 me dt.22.05.2015 dhe P.nr.485/2016 me dt. 21.05.2018 respektivisht kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore e deri me fillimin e hetimit disiplinor ndaj subjektit të lartcekur ka kaluar më tepër se dy (2) vite, ndërsa Ligji Nr.05/L-033 për Plotësim Ndryshim të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe Njoftimi për përmirësimin teknik në Ligji Nr.05/L-033 për Plotësim Ndryshim të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore, me nenin 15 paragrafi 1 (5) kishte paraparë se procedura disiplinore nuk mund të filloj dhe të zhvillohet në Komisionin Disiplinor pasi të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor për shkelje të supozuar dhe dy (2) Vite nga dita e shkeljes së supozuar.

Pra në rastin konkret kemi parashkrim të shkeljes së supozuar disiplinore ndaj gjyqtares T.K., Gjyqtare në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prizren sa i përket lëndëve penale P.nr. 1949/2012 dhe P.nr.485/16.

Në lëndën penale P.m. 1326/19 është ngritur aktakuza nga e Prokurorisë së Shtetit Departamenti i Përgjithshëm me datë 03.10.2019 ndaj të pandehurve D.H., me nofkën "K.....", D.B., dhe M.R., se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të Kodit nr.06/L-074 dhe ndaj të pandehurit R.G., për shkak se ka kryer veprën penale zjarr vënie nga neni 322 par.2 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074). Katër të akuzuarit kanë qëndruar në paraburgim prej datës 13.09.2019 deri më 13.10.2019. Shqyrtimi fillestar është mbajtur me datë 09.10.2019, ku të katër të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen. Gjykata i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar — D.H., me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 euro në të cilin dënim i është Ilogaritur koha e kaluar në paraburgim, D.B., me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro në të cilin dënim i është Ilogaritur koha e kaluar në paraburgim, M.R., me dënim me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro në të cilin dënim i është Ilogaritur koha e kaluar në paraburgim, kurse i akuzuari R.G., është dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim me pëlqim të akuzuarit në bazë të nenit 44 të KPK-së i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, në të cilin dënim i është Ilogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Ndaj këtij vendimi është parashtruar ankesë nga ana e mbrojtësit të akuzuarit D.H., dhe mbrojtësit e të akuzuarve të tjerë për shkak të lartësisë së dënimit, prokurori i shtetit nuk ka parashtruar ankesë. Gjykata e Apelit me Aktgjykim PAI Nr. 1 515/2019 me dt. 04.05.2020 e ka refuzuar ankesat dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 1326/19.

Në arsyetim Gjykata e Apelit ka cekur se vlerësimin e rrethanave relevante të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe se e njëjta është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe me shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarve. Zyra për ekzekutim të dënimeve me gjobë ka ekzekutuar dënimet me dt. 08.02.2021.


Duke pasur parasysh se lënda penale P.nr. 1326/2019 është gjykuar, ka pasur ankesë dhe është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit e cila ka pasur për detyrë që të verifikoj dhe të vendosi për shkeljet dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të lartcekur dhe nuk ka gjetur se ka shkelje të ligjit ose shkelje procedurale konsiderojmë se në rastin konkret nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve nr. 06/1—057, sa i përket Gjyqtare T.K.,

Nga të cekurat si më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji 06/1—057).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.1/23 me dt.15.02.2023

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



KËSHILLË JURUDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Kopja e vendimit i dërgohet:

-Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

-Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN.

-Gjyqtares T.K..